



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Gjakovës

Informatë mbi realizimin e Planit Vjetor të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm¹

Janar – Dhjetor 2024

Dhjetor, 2024

¹ Kjo informatë – raport është përgatitur me qëllim të informimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës dhe publikun implementimin e aktiviteteve të planifikuara vjetore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje
2. Llogaridhënia menaxheriale
3. Planifikimi i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm
4. Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve
5. Bashkëpunimi me Komitetin e Auditimit
6. Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit
7. Detyrat e Shërbimit Këshillues dhe aktivitete tjera

Akronimet

NJAB – Njësia e Auditimit të Brendshëm

USSP – Udhëheqësi i Subjektit të Sektorit Publik

KA – Komiteti i Auditimit

DQH-AB - Departamenti Qendror për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm

MFTP – Ministria e Financave, Transferve dhe Punës

DSHS - Detyrave të Shërbimit të Sigurisë

ZKA – Zyra Kombëtare të Auditimit

EA - Ekipi i Auditimit

PVZR – Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve

Hyrje

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në strukturën organizative të Komunës së Gjakovës është e sistemuar në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës, dhe ka për mision të ofroj shërbime të pavarura, objektive, siguroese dhe këshillëdhënëse të dizajnuara që të shtojnë vlerën dhe të përmirësojnë operacionet e organizatës. NJAB i ndihmon organizatën që të arrij objektivat e saja duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

NJAB operon me dy (2) auditor, nga të cilët njëri është edhe Udhëheqës i NJAB-ës. Sidoqoftë, gjatë vitit 2024 NJAB ka funksionuar vetëm me Udhëheqësin e njësisë meqenëse Auditori ka qenë në pushim pa pagesë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-021, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, NJAB ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i **raporton drejtpërdrejt vetëm udhëheqësit të subjektit të sektorit publik** dhe e njofton Komitetin e Auditimit. Në raport me strukturat tjera organizative në subjektin e sektorit publik, njësia për auditimin e brendshëm **ka pavarësinë funksionale** në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim.

Në harmoni me Udhëzimin Administrativ MF-NR.01/2019, për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, Kryetari e Komunës ka themeluar Komitetin e Auditimit (KA) si organ të pavarur këshillëdhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.

Në bazë të Planit Vjetor 2024 dhe Planit Strategjik 2024 – 2026, si dhe sipas plotësim/ndryshimit të planit vjetor, NJAB ka realizuar aktivitetet e auditimit gjatë vitit 2024.

* * *

Llogaridhënia menaxheriale

Lidhur me Informatë mbi realizimin e Planit Vjetor të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në konsultim me USSP – Kryetarin e Komunës, NJAB ka përgatitur një përmbledhje të aktiviteteve të kësaj njësie të cilat janë përfshirë në këtë informatë vjetore - raport, i cili do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës.

Udhëheqësi i NJAB-ës rregullisht i raporton Kryetarit të Komunës, si dhe Departamentit Qendrorë Harmonizues në Ministrinë e Financave, Transfereve dhe Punës (DQH/AB-MFTP), përmes Raporteve gjashtëmujore dhe Raportit Vjetor.

Për çdo raport individual të entitetit të audituar NJAB i raporton Kryetarit të Komunës, ndërsa një kopje të raportit ia dorëzon edhe udhëheqësit të drejtorisë/njesisë përkatëse.

Për periudhën raportuese, KA është njoftuar në kohë reale me aktivitetet e NJAB-ës.

Raporti i gjashtëmujorit të parë i NJAB-ës për vitin 2024, është aprovuar nga Kryetari i Komunës, me kohë dhe është dorëzuar tek DQH/AB-MFPT, dhe gjithashtu është shqyrtuar nga KA.

* * *

Planifikimi i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Në përputhje me Nenin 25 pika 3.3, të Ligjit Nr.06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, Udhëheqësi i NJAB-ës është i obliguar të bëjë përgatitjen dhe dorëzimin e Planit Strategjik dhe Planit Vjetor për rishikim dhe miratim tek USSP dhe KA, i cili obligim për vitin 2024 është kryer në kohë reale (në tremujorin e fundit të vitit 2023) nga Udhëheqësi i NJAB-ës, duke u bazuar në rreziqet që ndikojnë në objektivat e Komunës.

Në kuadër të Planit Vjetor për vitin 2024 kanë qenë të planifikuara pesë (5) aktivitete audituese, të bazuara në kapacitetet njerëzore të NJAB-së dhe vlerësimin e rrezikut sipas prioriteteve të përcaktuara nga shkalla e lartë e rrezikshmërisë (me koeficient nga 2.31 – 3), shkalla e mesme (me koeficient nga 1.71 – 2.30) dhe shkalla e ulët (me koeficient nga 1 – 1.70).

Plani Vjetor 2024 ka qenë i përgatitur për dy auditor (Udhëheqësi dhe Auditori), përdorur me dt. 01.03.2024 Auditori z. Blerim Morina ka parashtruar kërkesë për pezullim vullnetar të marrëdhënies së punës me qëllim të ngritjes profesionale dhe e njëjta iu është aprovuar nga USSP deri me 31.01.2025.

Rjedhimisht është ngritur nevoja për ndryshimin e planit vjetor, me ç'rast me dt. 17.10.2024 është bërë ndryshimi i planit vjetor duke e hequr një aktivitet të auditimit, duke e dërguar numrin total të aktiviteteve të planifikuara në katër (4), dhe është plotësuar aktiviteti i një auditimit nga i pajtueshmërisë në atë të performancës.

Plani Vjetor i NJAB-ës për vitin 2024 është realizuar plotësisht sipas objektivave të përshkruara në Planin Strategjik në përputhshmëri me aktivitetet për arritjen e çdo objektiwi veç e veç.

Në kuadër të Planit Vjetor të NJAB-ës përfshihet menaxhimi i kohës i cili kalkulohet për çdo aktivitet auditues, punë administrative, trajnime – aftësim të vazhdueshëm profesional si dhe hartimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor. Po ashtu, përveç kohës së planifikuar për shfrytëzimin e të drejtës së pushimit/ve, planifikohet shfrytëzimi i të drejtës së menaxhmentit të lartë për kryerjen e auditimit me kërkesë.

Procesi i auditimit gjatë aktivitetit auditues realizohet në 4 faza: planifikim, terren, raportim dhe përcjellje. Ky proces reflekton planin e veprimit për aktivitetin auditues.

Ndërsa menaxhmenti përkatësisht entiteti i audituar ka për obligim që të hartojë Planin e Veprimit² për zbatimin e re komandimeve të dhëna nga NJAB.

² Formulari Nr.3003 – Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit sipas numrit përkatës të referencës.

Bazuar në Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, NJAB përgatit Orarin e përcjelljes³ së zbatimit të rekomandimeve.

Auditimet e planifikuara për vitin 2024 kanë qenë:

1. Auditimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjakovës 2023 – 2024 (Të hyrat nga lejet e ndërtimit)
2. Auditimi i Drejtorisë për Infrastrukturë - Menaxhimi i Projekteve 2023 – 2024
3. Auditimi i Sektorit të Prokurimit 2023 – 2024
4. Auditimi i Performancës të Menaxhimit të Subvencioneve në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 2024 (aktiviteti është në fazën përfundimtare)

Në përputhje me Planin Vjetor për vitin 2024 dhe plotësim-ndryshimit të planit, të gjitha aktivitetet janë realizuar.

Për katër (4) auditimet e kryera janë hartuar raportet e auditimit dhe në **total janë dhënë 14 rekomandime** të cilat kanë qenë në përputhshmëri me të gjeturat e evidentuara në secilin raport veç e veç.

Në Raportin e Auditimit:

- Auditimi i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjakovës 2023 – 2024 (Të hyrat nga lejet e ndërtimit) janë dhënë tre (3) rekomandime.
- Auditimi i Drejtorisë për Infrastrukturë - Menaxhimi i Projekteve 2023 – 2024 janë dhënë dy (2) rekomandime.
- Auditim i Sektorit të Prokurimit: 2023 deri 2024 janë dhënë dy (2) rekomandime.
- Auditimi i Performancës të Menaxhimit të Subvencioneve në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 2024 janë dhënë shtatë (7) rekomandime (jo përfundimtare).

Gjatë kësaj periudhe raportuese, përveç Detyrave të Shërbimit të Sigurisë (DSHS), të realizuara nga NJAB, aktivitete tjera të cilat janë realizuar janë edhe DSHS, të cilat jo vetëm që i janë ofruar vetëm Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive komunale, por ato i janë ofruar edhe zyrtarëve komunal (shërbyesve civil).

Në përputhje me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e NJAB-ës, DSHS vazhdon të mbetet një aktivitet i vazhdueshëm i cili vazhdimisht realizohet nga NJAB respektivisht nga auditori i brendshëm.

Përderisa **sfida kryesore e NJAB-së mbete kapaciteti i vogël njerëzorë** për realizimin e aktiviteteve të auditimit e cila ka impakt negativ në cilësi dhe sasi të aktiviteteve që potencialisht mund të ndërmirren me synimin që të ofroj shërbime të pavarura, objektive, sigurose dhe këshillëdhënëse të dizajnuara që të shtojnë vlerën dhe të përmirësojnë operacionet e organizatës.

³ Formulari Nr.4001 – Orari i përcjelljes për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit sipas numrit përkatës të referencës.

Për këtë gjatë vitit 2024 nga ana e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është zhvilluar një procedurë e rekrutimit për Auditor, mirëpo e njëjta ka dështuar në mungesë të kandidatëve të përgjegjshëm.

* * *

Rishikimi i zbatimit të rekomandimeve

Në bazë të Orarit të përcjelljes për zbatimin e rekomandimeve, për 4 aktivitetet e auditimit të vitit 2024 janë dhënë 14 rekomandime prej të cilave 5 të planifikuara të zbatohen gjatë vitit 2024 dhe 9 prej tyre të zbatohen gjatë vitit 2025.

Gjatë fazës së përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve kemi verifikuar se prej 5 rekomandimeve të dhëna nga NJAB për vitin 2024, 4 rekomandime apo 80% janë zbatuar, dhe 1 mbetet të zbatohet deri në fund të muajit Dhjetor 2024. Përderisa 9 rekomandimet të cilat janë të planifikuara të zbatohen gjatë vitit 2025, do të kryhet faza e verifikimit mbi përfundimin dhe përcjelljen e zbatueshmërisë së rekomandimeve në koherencë me Orarin e përcjelljes për zbatimin e rekomandimeve të aktiviteteve përkatëse.

* * *

Bashkëpunimi me Komitetin e Auditimit

Duke u bazuar në Nenin 8 pika 5 e Udhëzimit Administrativ MF-NR.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, NJAB ofron shërbimet e sekretarisë për Komitetin e Auditimit. Në këtë drejtim NJAB ka përgatitur të gjitha materialet e nevojshme për trajtim në kuadër të takimeve të mbajtura nga KA, brenda kësaj periudhe raportuese.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2024 ka mbajtur gjithsej 3 takime të rregullta dhe 1 takim i planifikuar të mbahet në fund të muajit Dhjetor 2024. Përderisa, përbërja e KA-së gjatë këtij viti ka ndryshuar dhe se sfida kryesore akoma mbetet kompensimi në kohë i anëtarëve të Komitetit të Auditimit.

* * *

Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Gjatë procesit të aktivitetit auditues të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), Ekipi i Auditimit (EA) kërkon edhe raportet e auditimeve të kryera sipas Planit Vjetor të NJAB-ës, të cilat **Udhëheqësi i NJAB-ës ka për obligim që EA të ZKA-së t'ia dorëzoj kopjet e atyre raporteve**, të cilat ne i kemi kryer në kohë reale.

Në Raportin e Auditimit të ZKA-së, të publikuar në qershor të vitit 2024, i cili raport i referohet vitit paraprak – vitit 2023, janë dhënë dhjetë (10) rekomandime, për të cilat Komuna ka përgatitur dhe është në realizim të Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve (PVZR) të dhëna nga ZKA. Sipas obligimit ligjorë, me dt. 24.09.2024 Kryetari i Komunës ka dorëzuar pranë ZKA-së Raportin e I-rë periodik për zbatimin e PVZR-së.

* * *

Detyrat e Shërbimit Këshillues dhe aktivitete tjera të NJAB-ës

- Është përgatitur dhe mbajtur takimi për Kryetarin e Komunës, lidhur me raportin vjetor, të gjeturat dhe rekomandimet të cilat duhet të përcillen gjatë vitit 2025.
- Janë përgatitur materialin (dokumentacionin gjegjës) për shqyrtim nga ana e Komitetit të Auditimit për të gjitha takimet e mbajtura gjatë vitit 2024.
- Janë dhënë këshillë lidhur me plotësimin e Pyetësorit të vetëvlerësimit të komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Janë dhënë këshilla mbi bazat e qasjes së trajtimit të çështjeve të cilat janë parashtruar gjatë konsultimeve të drejtpërdrejta me Kryetarin e Komunës si dhe me drejtorët e drejtorive komunale.
- Është hartuar dhe miratuar Statuti i ri i NJAB-së.
- Janë dhënë këshilla për aktivitetet e ndërlydhura në fushën e prokurimit.
- Është këshilluar Koordinatori i Procesit lidhur me organizimin e takimit të Grupit Punues për çështjet audituese, lidhur me shqyrtimin e Raportit të auditimit të ZKA për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës për vitin 2023.
- Është këshilluar dhe asistuar Koordinatori i Procesit lidhur me hartimin e Draft Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna nga ZKA në Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023.
- Është asistuar Koordinatori i Procesit në përpilimin e Raportit të I-rë Periodik për zbatimin e PVZR.
- Është kryer monitorimi i NJAB-së Gjakovë nga ana e Njësisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, dhe janë realizuar rekomandimet e dhëna.
- Bashkëpunimi me BIRN lidhur me AuditMetri - Raporti i Monitorimit të Auditimit të Brendshëm.
- Pjesëmarrja në tryezën në rrumbullakët - Udhëzuesi i Praktikave të mira të Auditimit të Performancës të organizuar nga USAID KMI në bashkëpunim me DQH - 19/03/2024.
- Pjesëmarrja në konferencën e organizuar nga KDI "Analizës gjithëpërfshirëse mbi përsëritjen dhe nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve të dala nga raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit ZKA për 12 komuna të Kosovës" - 22/10/2024.
- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga USAID-KMI me temën "Metodologjia e Mostrimit në Auditim" - 20/11/2024;
- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga USAID, NJQH-AB dhe IKAP me temën "Trajnimi për Auditimin e Performancës për auditorët e brendshëm" - 22/11/2024.
- Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga IKAP dhe NJQH-AB me temën "Sistemin Informativ për Raportimin e Auditimit të Brendshëm - SIRAB" - 04/12/2024 (planifikuar).
- Takim pune me zyrtarët nga NJQH-AB lidhur me Auditimin e Performancës.
- Janë zhvilluar takime konsultative - profesionale me drejtorët e NJAB-ve nga niveli qendror dhe lokal.
- Janë zhvilluar takime konsultative me Ekipin e Auditorëve të Jashtëm të angazhuar nga ZKA.

Data, 02.12.2024
Komuna e Gjakovës

Arbër Gola,
Udhëheqës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm